

VENDIMI
Nr.8, datë 18.9.1992

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga:

Rustem Gjata, Kryetari Gjykatës Kushtetuese

Feti Gjilani,	"	"
Hilmi Dakli,	"	"
Manol Konomi,	"	"
Franc Jakova,	"	"
Thimjo Kondi,	"	"
Natasha Sheshi,	"	"
Veli Budo,	"	"
Ylvi Myrtja,	"	"

Asistuar prej sekretares Drita Filto, më datat 25.8.1992, 02.09.1992 dhe 18.09.1992, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.6 që i përket
KËRKUESE: GJYKATA E RRETHIT TIRANE

OBJEKTI I KËRKESËS

Papajftueshmëria e nenit 14/4 të ligjit Nr.7566, datë 25.05.1992 "Për armët" me dispozitat kryesore kushtetuese.

Gjykata Kushtetuese pasi dëgjoi relacionin

VËREN

Gjykata e rrethit Tiranë me shkresën datë 18.7.1992, kërkon shfuqizimin e fjalisë së dytë të paragrafit të katërt të nenit 14 të ligjit nr.7566, datë 25.5.1992 "Për armët", ku bëhet fjalë për arrestimin e autorëve të veprave penale të armëmbajtjes pa leje se cënon pavarësinë e gjykatave dhe nuk u jep mundësi për zgjedhjen e masës së sigurimit rast pas rasti siç parashikohet në Kodin e Procedurës Penale.

Edhe Prokurori i Përgjithshëm, me shkresën nr.766, datë 27.7.1992, kërkon shfuqizimin e fjalisë së parë të paragrafit të katërt të nenit 14 të ligjit "Për armët", ku bëhet fjalë për kontrollin e banesës, se vjen në kundërshtim me dispozitat kryesore kushtetuese.

Pavarësisht se Prokurori i Përgjithshëm nuk ka të drejtë të bëjë kërkesë për fillimin e procedurës për shqyrtimin e akteve ligjore e nënligjore, meqënëse objekti i gjykimit të çështjes ka të bëjë me të drejta kushtetuese, gjykata në bazë të nenit 25/1 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", vendosi të shqyrtojë çështjen me nismën e saj.

Paragrafi i katërt i nenit 14 të ligjit "Për armët", ve rregulla të karakterit procedural-penal për kontrollin dhe masat e sigurimit.

Kontrolli është një nocion i gjerë që përfshin kontrollin e personit, të banesës, të lokaleve, etj. Përcaktimi: "Lejohen forcat e rendit të bëjnë kontrolle për armëmbajtje pa leje...", u le dorë krejt të lirë forcave të rendit që për çdo dyshim armëmbajtjeje pa leje të bëjnë kontrolle vetiake të cilitdo person fizik e të banesës së tij pa asnjë miratim paraprak të prokurorit dhe madje pa e njoftuar fare atë, menjëherë pas kryerjes së kontrollit.

Ky formulim përbën një shkelje të parimit se: "Republika e Shqipërisë është shtet juridik dhe demokratik (paragrafi i parë i nenit 2 të ligjit nr.7491, datë 29.04.1991 "Për dispozitat

kryesore kushtetuese"), e madje cënon dinjitetin e njeriut dhe paprekshmërinë e banesës, që janë sanksionuar si të drejta themelore të tij (paragrafi i dytë i të njëjtit nen)".

Por nevoja e luftës kundër krimit të armëmbajtjes pa leje, që është rritur në mënyrë të ndjeshme, duke u bërë shqetësues për tërë shoqërinë, në kushtet e tanishme kërkon që, në raste përjashtimore e me kufizime apo kushtëzime të përcaktuara qartë në dispozitat ligjore përkatëse, të lejohen organet e policisë për të kryer kontrolle pa miratimin paraprak të prokurorit.

Përjashtimet për organet e policisë në kryerjen e kontrolleve, pa miratimin paraprak dhe të arsyetuar të organit kompetent gjyqësor, duhet të parashikohen shprehimisht në ligjin objekt shqyrtimi, si raste të veçanta, të ngutshme dhe flagrante. Në këtë vështrim, kontrolli për armëmbajtje pa leje nga forcat e rendit mund të kryhet vetëm në raste krejt përjashtimore dhe duke respektuar kërkesat e neneve 85, 86, 89 e 92 të Kodit të Procedurës Penale dhe të neneve 21 e 23 të ligjit nr.7504, datë 30.7.1991 "Për Policinë e Rendit". Megjithatë, duhet theksuar se oficerët e policisë menjëherë pas kryerjes së çdo kontrolli por jo më vonë se 12 orë nga përfundimi i tij, detyrohen të njoftojnë prokurorin e rrethit përkatës për miratim. Vënia e kufizimeve dhe detyrimi për të njoftuar prokurorin është i domosdoshëm në kuadrin e mbrojtjes së dinjitetit të njeriut dhe njëres nga të drejtat themelore të tij, siç është paprekshmëria e banesës.

Fjalja e dytë e paragrafit të katërt të nenit 14 të ligjit "Për armët" ku thuhet: "Autorët e veprës penale të armëmbajtjes pa leje të hetohen e gjykohen në gjendje arresti", i ka hequr të drejtën e vlerësimit të masës së sigurimit organit kompetent gjyqësor. Urdhërimi që bëhet në këtë dispozitë është i detyrueshëm për të gjitha rastet e armëmbajtjes pa leje. Për pasojë, masa e arrestit duhet të aplikohet për të gjithë autorët që akuzohen për armëmbajtje pa leje.

Hetimi dhe gjykimi i të gjithë të pandehurve për vepra penale të armëmbajtjes pa leje vetëm në gjendje arresti vjen në kundërshtim me parimet e sanksionuara në dispozitat kryesore kushtetuese dhe konkretisht me parimin e pavarësisë së pushtetit gjyqësor. Në nenin 1 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", thuhet shprehimisht se : "Pushteti gjyqësor është i ndarë dhe i pavarur nga pushtetet e tjera. Ai ushtrohet vetëm nga organet e njohura nga ligji "Për dispozitat kryesore kushtetuese".

Ndjekja penale dhe gjykimi në gjendje arresti i të gjithë të pandehurve për vepra penale të armëmbajtjes pa leje, siç parashikohet në ligjin "Për armët", cënon rëndë parimin kushtetues të pavarësisë së gjykatave të sanksionuar edhe në nenin 8/1 të ligjit të lartpërmendur ku thuhet : "Në ushtrimin e kompetencave të tyre, gjyqtarët janë të pavarur dhe i nënshtrohen vetëm ligjit "Për dispozitat kryesore kushtetuese" dhe ligjeve. Për të siguruar zhvillimin e drejtë dhe të shpejtë të hetimit e të gjykimit, gjykata, gjyqtari i vetëm dhe hetuesi kanë të drejtë të marrin masa sigurimi kundrejt një personi që është marrë si i pandehur" (neni 47 i Kodit të Procedurës Penale). Zgjedhja e masës së sigurimit lihet në çmuarjen e gjykatës, gjyqtarit dhe hetuesit në përputhje me rrethanat e çështjes, rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale e të fajtorit dhe personalitetit të tij. Në zgjedhjen e masës së sigurimit, gjyqtarët, prokurorët dhe hetuesit mbajnë parasysh përveç veprës penale që i ngarkohet të pandehurit provat që rëndojnë kundër tij, mundësinë e fshehjes nga hetimi dhe gjykimi, mundësinë e zhdukjes së provave dhe pengimin e zbulimit të së vërtetës nga autori, mundësinë e vazhdimin të veprimtarisë kriminale, gjendjen shëndetësore të të pandehurit, përshtypjen që ka shkaktuar vepra penale, rrezikun e pasojave të tjera, moshën, gjendjen familjare, etj. Pa u analizuar për çdo rast rrethanat e mësipërme nuk ka se si të vendoset për masën e sigurimit që duhet të abatohet kundër të pandehurve që akuzohen për armëmbajtje pa leje.

Masa e arrestit, për nga natyra fakultative e tij, e cila bazohet në kriteret e lartpërmendura, është një prerogativë e pushtetit gjyqësor, parim ky i sanksionuar edhe në nenin 49 të Kodit të Procedurës Penale, ku thuhet: "Arrestimi, si masë sigurimi që merret nga gjykata ose hetuesi mund të zbatohet për vepra penale...".

Duke analizuar sa më sipër, Gjykata Kushtetuese arrin në konkluzionin se paragrafi i katërt i nenit 14 të ligjit nr.7566, datë 25.5.1992 "Për armët", është i papajtueshëm me dispozitat

kryesore kushtetuese.

Në këto rrethana kërkesa e gjykatës së rrethit Tiranë, është e bazuar dhe si e tillë duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 24 pika 3 dhe neneve 25/1 dhe 26/5 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991, "Për dispozitat kryesore kushtetuese"",

VENDOSI

Fjala e parë e paragrafit të katërt të nenit 14 të ligjit nr.7566, datë 25.5.1992 "Për armët" të ndryshohet si vijon:

"Organet e policisë së rendit lejohen që pa miratimin paraprak të prokurorit të rrethit përkatës, të kryejnë kontrole të personit ose të banesës vetëm në raste flagrante ose kur kanë të dhëna mjaftësisht të bazuara se ai mban pa leje armë, municione apo eksploziv. Menjëherë pas kryerjes së çdo kontrolli të tillë, e gjithësesi jo më vonë se 12 orë nga përfundimi i tij, organet e policisë detyrohen të njoftojnë prokurorin e rrethit përkatës për miratim".

- Shfuqizimin e fjalisë së dytë të paragrafit të katërt të nenit 14 të ligjit nr.7566, datë 25.5.1992 "Për armët", me këtë përmbajtje:

"Autorët e veprës penale të armëmbajtjes pa leje të hetohen e gjykohen në gjendje arresti".

Vendimi është përfundimtar dhe i formës së prerë.

Ky vendim hyn në fuqi me botimin e tij në Fletoren Zyrtare.